REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC
Nr. Br. No. 01-060-01-36792-26
Nr. i fq. / Br.str. / No.pg. 1-5
Data / Datum / Date 16.11.2026
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.28.10.2026, në ora 11:30 në sallën e Kuvendit Komunal.
Të pranishëm ishin: Sami Ahmeti, Fjolla Nasufi, Albanë Shillova Shalaku, Vlora Mjekiqi Kabashi, Labinot Mirena, Abdyrrahman Krasniqi dhe Dorentina Krasniqi
Tëpranishëmtëtjerë: Kryetari i Komunës z.Halil Thaçi, drejtorët komunal e tjerë
Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së, e mbajtur me dt.25.09.2026
3. Shqyrtimi i Raportit finaciar të shpenzimeve për periudhën janar-shtator 2026, të paraqitur nga drejtori i DEFZH-së, me nr.04-052-01-32787-26, dt.14.10.2026
4. Shqyrtimi i kërkesës për rritjen-tejkalimin e të hyrave vetanake të vitit 2026 të paraqitur nga drejtori i DEFDZH-së, me nr.04-400/01-33192/26, të dt.16.10.2026
5. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës me nr.02-020-01-32774-26, të dt.14.10.2026 për raportin në lidhje me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi
6. Shqyrtimi i kërkesës së drejtoreshës të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) me nr.10-104-02-28241-26, të dt.11.09.2026 për regjistrimin e pronës shoqërore Shkolla Fillore "Vëllaznimi" në emër të Komunës së Obiliqit
7. Shqyrtimi i kërkesës së drejtoreshës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) me nr.14-104/02-30532/26, dt.30.09.2026për regjistrimin e pronës shoqërore Shkolla Fillore 'Milloshevë' në emër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport-Komuna e Obiliqit
8. Shqyrtimi i kërkesës së drejtoreshës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) me nr.14-104/02-33246/26, dt.19.10.2026për bartjen e pronës së Shtëpisë së Kulturës në Plemetin në emër të Komunës së Obiliqit
9. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës me nr.02-020-01-31469-26, të dt.06.10.2026 për vendosjen në debat publik të Draft-Planit Komunal për Integritet për periudhën 2027-2030
10. Shqyrtimi i Projekt-Propozimit të drejtorit të DPUKP-së, me nr.05-463/06-33311/26, dt.19.10.2026 për fillimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të hollësishëm
11. Të ndryshme

Labinot Mirena - Kërkoj të mbajmë një minut heshtje për vrasjen e znj.Arlinda Zekaj.
Kryesuesi - Ju ftoj për një minut heshtje për vrasjen e znj.Arlinda Zekaj, duke shpresuar që ky të jetë rasti i fundit në Kosovë.
Pas nderimit me një minut heshtje nga të pranishmit, kryesuesi i njoftoi me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës
Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.
Pika 2 e rendit të ditës
Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.
Pika 3 e rendit të ditës
Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e Raportit finaciar të shpenzimeve për periudhën janar-shtator 2026 dhe fjalën ia dha drejtorit të DEFZh-së.
Besnik Krasniqi – Ne e kemi bërë një raport financiar të shpenzimeve për periudhën janar-shtator 2026, që besoj se materialin e keni dhe, nëse keni ndonjë pyetje, mund të bëni.
Fjolla Nasufi – Materialin e kemi marrë dhe nuk kemi ndonjë pyetje, kështu që ia rekomandojmë Kuvendit Komunal.
Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit Komunal të shqyrtoj Raportin finaciar të shpenzimeve, të paraqitur nga drejtori i DEFZH-së.
Pika 4 e rendit të ditës
Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës për rritjen-tejkalimin e të hyrave vetanake të vitit 2026, të paraqitur nga drejtori i DEFDZH-së, dhe për një shpjegim më të gjerë fjalën ia dha drejtorit të DEFZH-së.
Besnik Krasniqi – Këtu kemi një kërkesë për rritjen-tejkalimin e të hyrave vetanake. Për vitin 2026 kanë qenë 1,398,314 €, dhe tash kemi një tejkalim që kemi bërë kërkesë për 350,000 €, deri në fund të vitit.Do të thotë që planifikojmë me pasë të hyra. Te Drejtoria e Administratës janë të parapara 74,000 €, 126,000 te Drejtoria e Infrastrukturës Rrugore, 105,000 te Infrastruktura Publike dhe te Drejtoria e Arsimit 45,000 €, Totali është 350,000 €, të hyra që planifikojmë t'i kemi deri në fund të vitit .
Vlora Mjekiqi Kabashi – Vërtetë, është një lajm i mirë, sepse ka arritur Komuna e Obiliqit të rrisë tejkalimin e të hyrave vetanake dhe normal që jemi për t' ia rekomanduar Kuvendit Komunal për aprovim.
Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës për rritjen-tejkalimin e të hyrave vetanake të vitit 2026 të paraqitur nga drejtori i DEFZH-së.
Pika 5 e rendit të ditës
Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për raportin në lidhje me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Ju informoj se zakonisht ky raport nuk është bërë, por kjo bëhet për çështje të transparencës së punës dhe performancës, qe në të ardhmen të ketë më shumë pikë në performancë. Kryetari ka shprehë dëshirën për të bërë një raportim lidhur me të gjitha takimet e mbajtura deri më tani.
Anëtarët e Kuvendit Komunal me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës, për raportin në lidhje me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.
Pika 6 e rendit të ditës
Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së drejtoreshës të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) për regjistrimin e pronës shoqërore Shkolla Fillore "Vëllaznimi" në emër të Komunës së Obiliqit. Ne këtë kërkesë e kemi shqyrtuar edhe në muajin e kaluar dhe fillimisht na është rekomanduar se nuk ka nevojë Kuvendi të nxjerrë ndonjë vendim. Megjithatë, drejtori i DPUKP-së, ka zhvilluar disa takime në MAPL dhe me institucione tjera, të cilat i kanë rekomanduar që kjo çështje përsëri të bëhet përmes Kuvendit.
Sevdije Berisha – Drejtoria e Arsimit i propozon Kuvendit Komunal të shqyrtojë dhe miratoj kërkesën për regjistrimin në kadastër të njësive kadastrale në emër të Komunës së Obiliqit, që aktualisht figuron në emër të shfrytëzuesit të shkollës fillore "Vëllaznimi".
Kryesuesi – Ju lutem që deri nesër ta sqaroni bazën ligjore lidhur me vendimin që do ta marrim në Kuvendin Komunal.
Vlora Mjekiqi Kabashi – Po flas nga përvojat e mëhershme që kemi pasë çerdhja që është te lagjja e Hashanëve, kemi pasë dëshirën me bartë në emër të Komunës, por paraprakisht ka pasë vendim të mëhershëm nga Kuvendi Komunal dhe është dashtë dashtë të shfuqizohet ai vendim për t'u bartë prona në

emër të Komunës. Prandaj, a jeni në dijeni a ka pasë vendim të mëhershëm të nxjerrë nga ky Kuvend që është bartë, apo jo.

Sevdije Berisha – Nuk kemi ndonjë vendim që ka pasë eventualisht për këtë çështje që ju po e paraqitni.

Abdyrrahman Krasniqi – Sa i përket kësaj çështjeje, kryesues, besoj se regjistrimi ose bartja në pronën e Komunës, duhet të kaloj përmes Drejtorisë së Urbanizmit, e jo përmes Kuvendit, por shikone edhe Rregulloren edhe procedurat si janë. Është më mirë që drejtori le të merrë kohë se sa ne të marrim vendim dhe me u kthye nga MAPL-ja, sepse nuk është diçka që e trajton Kuvendi. Nëse kishim me falë ndonjë pronë, kishte mundësi me qenë përmes Kuvendit, në të kundërtën po e kthejmë një pronë dhe e regjistrojmë si aset komunal, që mendoj se Drejtoria e Urbanizmit bashkë me Drejtorinë e Arsimit, duhet ta bëjnë këtë punë. Ne kemi edhe shumë objekte tjera, që janë të përfunduara në Komunën tonë dhe nuk janë të regjistruara si asete të Komunës, dhe ndoshta kishte me qenë mirë të mendohet edhe për këto që të regjistrohen në të ardhmen.

Kryesuesi - Është pikërisht ajo që e thamë në fillim, se edhe unë nuk jam mjaftueshëm i bindur që funksionon kështu, por gjithsesi ne si Kuvend jemi në shërbim të politikave të mira që bëhen për Komunën dhe për secil n Drejtori që ka nevojë për mbështetjen tonë. Ne gjithsesi që jemi për me i mbështetë nismat ligjore, ashtu qysh e thashë edhe në fillim edhe për çështje të performancës dhe të gjithave, mos me qenë një vendim më tepër i nxjerrë nga Kuvendi kur nuk është mjaftueshëm i ligjshëm.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit Komunal të shqyrtoj dhe të miratoj kërkesën e drejtoreshës të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) për regjistrimin e pronës shoqërore Shkolla Fillore "Vëllaznimi", në emër të Komunës së Obiliqit.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së drejtoreshës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për regjistrimin e pronës shoqërore Shkolla Fillore''Milloshevë'', në emër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport-Komuna e Obiliqit. Kjo pronë në librin kadastral është e regjistruar në emrin Shkolla Fillore-Milloshevë, që nuk ka logjikë, por kështu figuron në dokument. Për një shpjegim më të gjerë rreth kësaj fjalën ia japë drejtoreshës së DKRS-së.

Ilire Kelmendi Shema - Unë këtë kërkesë e kam sjellë nga mundësia për arsye se 1.7 milionë €, i kemi donacion prej Ministrisë së Sportit për investim në stadiumin në Milloshevë. Arsyeja është se është në emër të Shkollës Fillore'' Millosheva'', dhe më duhet me bartë në Drejtorinë time. Kjo është arsyeja dhe mënyra qysh e ka kërkuar Ministria dhe nuk dua t'i humbë 1.7 milionë €, për me i investuar në stadium. Shpresoj se të gjithë do të bashkangjiteni me mua dhe, nëse diçka e kthen atëherë mbetet te Kuvendi.

Kryesuesi - Unë sa kuptova, bëhet fjalë për fushën e sportit në Milloshevë dhe njëfarë objekti përcjellës që është aty. Për me mund me marrë donacionin prej 1.7 milionë €, dhe për t'u bërë ai ndërtim në Milloshevë, duhet të mos jetë shkolla fillore "Millosheva", por DKRS-ja.

Labinot Mirena – Më e pakta që ne mund të bëjmë si të përzgjedhur të popullit është me votu këtë projekt 1.7 milionë €, për Komunën e Obiliqit, për një fushë sportive, që është më se e nevojshme dhe e domosdoshme për të gjithë rininë që bëjnë aktivitete sportive atje. Unë të përgëzoj për këtë projekt iniciativën që e ke, por kërkoj prej teje që mos me u ndalë sepse janë edhe dy fusha tjera, kjo që është në Obiliq dhe ajo në Raskovë, atje që edhe për këto me pasë edhe ndonjë projekt.

Ilire Kelmendi Shema – E fakenderoj shumë asambleistin, unë ju premtoj se në vitin e ardhshëm do të jemi edhe me Raskovën, ndërsa me Federatën e Futbollit do të jetë stadiumi kryesor.

Abdyrrahman Krasniqi – Kryesues, mendoj se prapë jemi në temën e njejtë te regjistrimi i pronave, që besoj se ndoshta, kishte me qenë mirë ne me formuar një Komision të përbashkët për trajtimin e gjithë këtyre pronave. Komisioni i formuar prej Kuvendit dhe Ekzekutivit kishte me ia lehtësu Drejtorisë së Urbanizmit detyrën dhe vendimmarrjen sepse ne po e shohim se shkolla e Milloshevës është pronë publike, do të thotë është pronë komunale vetëm po kalon tash te Drejtoria. Unë e përgëzoj drejtoreshën edhe një herë për përfitimin e këtij projekti shumë të qëlluar. Për mos me humbë ne shumë kohë me pritë ligjshmërinë e MAPL-së, ndoshta kishte me qenë mirë me veprue kështu, ky është sugjerimi im por gjithsesi me i pa mundësitë qysh janë me rregullu këtë çështje sa më shpejtë.

Kryesuesi – Ne e vlerësojmë shumë përvojën tënde dhe je shumë i mirëseardhur në komentet tua sepse zakonisht i ke shumë të sakta dhe të përgëzoj për këtë çështje. Ne kemi biseduar me drejtorin e Urbanizmit që në muajt në vijim pikërisht, këtë që po e thoni ju dhe ai veç e kishte angazhuar Drejtorinë në mbledhjen e të gjitha informatave për krejtë pronat që i ka Komuna, me natyrë të njejtë në mënyrë që në një seancë me i bërë të gjitha përnjëherë dhe me i kalue në emër të Komunës, apo sido që të jetë e nevojshme. Andaj, edhe ju drejtoreshë deri nesër me marrë krejtë bazën ligjore për këtë çështje.
Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit Komunal të shqyrtoj dhe të miratoj kërkesën e drejtoreshës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) për regjistrimin e pronës shoqërore Shkolla Fillore'' Milloshevë'', në emër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport-Komuna e Obiliqit.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së drejtoreshës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) për bartjen e pronës së Shtëpisë së Kulturës në Plemetin në emër të Komunës së Obiliqit dhe për një shpjegim më të gjerë rreth kësaj fjalën ia dha drejtoreshës së DKRS-së.

Ilire Kelmendi Shema - Këtu, e kemi problemin tjetër se duhet t'i kryej obligimet të cilat janë me rrymë, ujë dhe mbeturina dhe unë po kam problem me i krye për arsye të pronës, e cila është shfrytëzue nga komuniteti atje, për me kthye në Komunën e Obiliqit, me i krye pagesat me rregullë dhe me marrë Komuna, por njëkohësisht shfrytëzues me qenë DKRS-ja sepse aktivitetet bëhen nga Drejtoria ime aty.
Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit Komunal të shqyrtoj dhe të miratoj kërkesën e drejtoreshës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) për bartjen e pronës së Shtëpisë së Kulturës në Plemetin në emër të Komunës së Obiliqit.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për vendosjen në debat publik të Draft-Planit Komunal për Integritet për periudhën 2027-2030.
Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit Komunal të shqyrtoj dhe të miratoj kërkesën e Kryetarit të Komunës për vendosjen në debat publik të Draft-Planit Komunal për Integritet për periudhën 2027-2030.

Pika 10 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e Projekt-Propozimit të drejtorit të DPUKP-së, për fillimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të hollësishëm.Unë i kam kërkuar disa shpjegime drejtorit dhe ai më ka thënë se ky është Plani i hollësishëm për një zonë të caktuar, që ka të bëjë vetëm me zonën në qendër me Obiliqin, si tërësi.

Labinot Mirena – Kryesues, a preket edhe koeficienti i ndërtimit në zonën në qendër nëse, për shembull është dikund 2.5 nuk e di saktësisht a bëhet 3.2.

Kryesuesi – Ky plan ka të bëjë vetëm me zonën në qendër dhe nuk e kam këtë informacion z.Mirena, por nesër mundemi me kërkue.

Abdyrrahman Krasniqi – Kryesues, ne këtu i kemi 2 tema, e kemi planin zhvillimor dhe hartat zonale. Plani zhvillimor është më i përgjithshëm ndërsa, hartat zonale e specifikojnë në mënyrë specifike saktë çka ka me u bërë edhe mbitokë dhe nëntokë. Unë prapë po them kishte me qenë mirë mos me ra edhe ne në lajthitje me shikuar se a kemi të drejtë ligjore me bërë këtë ndryshim plotësim, me bisedue me drejtorin. Mendoj se kishte qenë mirë me qenë drejtori këtu, me na sqarue pak më detajisht edhe pse e kemi MAPL-në, ne kemi vendime që janë marrë në këtë Kuvend dhe njerëzit janë nëpër procedura.

Kryesuesi – E saktë është. Kjo ka të bëjë me fillimin e procedurave për hartimin e Planit dhe drejtori do të jetë nesër prezentë për dhënien e përgjegjeve në pyetjet e juaja.

Abdyrrahman Krasniqi - Atëherë, pse me marrë pëlqimin prej neve, nëse drejtori e ka parë të arsyeshme Drejtoria është ajo që e vendos për këtë projekt.
Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për, dhe 1 votë abstenim ia rekomanduan Kuvendit Komunal të shqyrtoj dhe të miratoj Projekt-Propozimit të drejtorit të DPUKP-së, për fillimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të hollësishëm.

Pika 11 e rendit të ditës

Vlora Mjekiqi Kabashi – Kryesues, duke pasë parasysh se iu kam njoftuar me kohë për mbledhjen e kaluar, kam pasë probleme shëndetësore dhe nuk kam mundur me qenë pjesë e mbledhjes në bazë të transmetimit direkt, kam parë se ka qenë si pikë e rendit të ditës raporti i performancës, ku është përmendë edhe Kuvendi i cili ka marrë 0 pikë. Unë kisha dashtë që në mbledhjen e nesërme të jetë z.Adem Haliti, të sqaroj se pse është raporti 0 te Kuvendi, kur e dijmë shumë mirë se ne kemi bashkëpunuar në vazhdimësi. Unë e pranoj se raportin përfundimtar nuk e kam punuar sepse mbledhja e fundit ka qenë në nëntor por një raport të tillë ashtu të përmbledhur siç e keni arsyetuar edhe ju vetë, e keni bërë që ka qenë në janar. Andaj, unë kisha pasë dëshirë të më sqaroj në mënyrë më të hollësishme rreth raportit të performancës sa i përket Kuvendit Komunal.

Kryesuesi – Gjithsesi, ne do ta informojmë z.Haliti, që të vjen dhe të na përgjegjet lidhur me këtë pikë.

Abdyrrahman Krasniqi – Kryesues, a keni ndonjë raport që jeni ankuar dhe është kthye për performancë?

Kryesuesi – E kanë kthyer, se shefat e grupeve tashmë, janë hequr. E kanë kthyer që i kanë përmirësuar shumë çështje teknike, më shumë që kanë pasë partitë. PSD-ja, që kanë pasë emërtime të ndryshme dhe kanë thënë se tash e tutje duhet të kenë shumë kujdes, që ta vëzhgojnë mos të ketë më gabime. Në rast se ju shihni se po bëhet shkelja e të drejtave të anëtarëve të Kuvendit gjithsesi ne mund të kërkojmë dhe e tërheqim atë marrëveshje dhe më nuk ka nevojë ata me ardhë edhe të na mbikqyrin.

Abdyrrahman Krasniqi – Unë kam vërejtje lidhur me këtë vlerësim, sepse ne të gjithë e dijmë si bëhen vlerësimet dhe sa është një asambleistë produktiv. Mendoj se produktiviteti i një asambleisti matet me performancën e tij në shërbim të institucionit, do të thotë çka ka votuar ai asambleistë ose çka ka debatuar, ajo temë ka qenë në interes të Komunës dhe qytetarëve të Komunës. Vlerësimi që na ka ardhë herën e fundit, besoj se ka qenë jashtë çdo norme vlerësuese, sepse nuk mundemi ne me vlerësu dikë që vetëm kundërshton, ose vetëm folë se e kam shok këtë ose atë dhe në fund i merrë pikët për shkak të angazhimit në Kuvend. Besoj se një organizatë duhet me vlerësue angazhimin dhe produktivitetin, çka është në interes të institucionit dhe të komunitetit. Edhe nëse asambleisti e kundërshton një temë që ka qenë në dëm të komunitetit atëherë kjo është për t'u vlerësuar, por jo vlerësimin qysh e kanë bërë deri aty. Vlerësimi im është se ata nuk kanë masa vlerësuese dhe nuk kanë hy hollësisht me i lexuar fjalimet konkretisht çka kanë folur asambleistët. Nëse ata nuk kanë kohë të merren me asambleistët dhe me tema që ne i diskutojmë, unë jam kundër këtij projekti ,sepse nuk jam vetëm me ardhë këtu, me marrë një pagë. Një asambleistë që nuk e ka asnjë vlerë dhe asnjë kontribut për Komunën, me paraqitë atë me performancën më të mirë ose më të vlerësuarin, kjo është një lloj ofendim për neve tjerëve këtu. Prandaj, është mirë ose me caktu një takimose me shiku metodën e vlerësimit qysh e kanë ata edhe me diskutu se a po vazhdojmë tutje ose jo.

Kryesuesi – Gjithsesi, të paktën për këtë punë më keni krahë në çdo aspekt dhe unë kam reague menjëherë. Ju kam shkruar dhe më kanë kërkuar falje për gabimin që e kanë bërë. Tash, puna e tyre do të vërtetohet se a ka qenë kërkimfalje, veç me thënë apo vërtetë kanë kry punë. Në raportin vijues ne do të shohim se a ka diçka të tillë dhe do të kërkojmë takim, i thërrasim në Kuvend ashtu qysh kanë ardhë atë ditë me bërë prezentimin e platformës. Unë nuk jam për atë që asnjë anëtarë i Kuvendit të nëpërkëmbet, të përdoret apo të keqpërdoret sepse ne jemi të zgjedhur prej qytetarëve dhe gjithsesi duhet të jemi në të mirën e qytetarëve. Pajtohem me ty se jo gjithmonë veç me folë është vlerë sepse është më vlerë ajo çka themi, çka ndërmarrim, çfarë pyetje ngritim, çka kërkojmë ne prej Ekzekutivit, që me rregulluar jetën e qytetarëve tonë. Këtë procesverbal të KPF-se duhet me ia përcjellë asaj organizate që të dinë se çka kemi folë në mënyrë që të marrin të gjitha masat dhe vlerësimi të jetë ashtu qysh duhet të jetë, e jo të jetë pse dikush veç foli ose foli më shumë, por të jetë se çka tha, çfarë propozimesh dha ashtu pikërisht qysh po thoni edhe ju.

Mbledhja përfundoi në ora 12:2'

Zyrtare e lartë për punë të KK

Azize Zeneli

Kryesues i Komitetit

Sami Ahmeti